



INFORMACION MBI TAKSAT DHE TATIMET

Për shërbimet e sigurimit janë të zbatueshme taksat dhe tatimet sipas legjislacionit në fuqi:

Ligj Nr. 92/2014 “Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”

Neni 53 “Përfshirje për disa veprimtari të tjera”

Janë furnizime të përfshira nga TVSH-ja transaksionet e mëposhtme:

a) shërbimet e sigurimit dhe të risigurimit, përfshirë kryerjen e shërbimeve të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime nga agjentët dhe brokerat e sigurimit.

Ligj Nr.9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare i ndryshuar”

Neni 4 “Niveli i taksave Kombëtare”

10. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është 10 për qind e shumës së primit. (Ndryshuar me Ligj Nr. 127/2016, datë 15.12.2016. Botuar në Fletoren zyrtare nr. 250 datë 27.12.2016).

Ligj Nr.8438, datë 28.12.998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat”

Neni 20 “Shpenzime të njohura”

Shpenzimet e sigurimit të jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve nga punëdhënësi konsiderohen si shpenzime të njohura.

Për produktet e sigurimit me elementë kursimi:

- Për produktin “Sigurimi i Jetës me Mbijetesë” përfitimet në maturim të sigurimit taten vetëm për diferencën midis vlerës totale të përfituar dhe vlerës së investuar
- Për produktin “Sigurimi i Jetës me Kursim” përgjatë gjithë periudhës së sigurimit, punëdhënësit i njihen shpenzimet për sigurimin e jetës së punëmarrësve (sipas ligjit Nr.8438, datë 28.12.998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat”), ndërsa punëmarresi taten për përfitimin nga sigurimi (investim+interes) vetëm në maturim të periudhës së sigurimit.

Dëmet e rimbursuara nuk janë subjekt taksimi, pasi nuk konsiderohen të ardhura.
